



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.  
DREJTORIA E PROKURIMEVE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Për:** BO“Strict sh.p.k & Klajger Konstruksion” sh.p.k

**Adresa:**” Strict” shpk Tiranë,Njësia Bashkiake Nr,11 Blloku Gintash,2 kateshet e biznesit,shk 2 kati 2 Laprak dhe “Klajger Konstruksion” sh.p.k me adresë: Tiranë,Kamëz Bathore (pranë kopshtit të femijëve nr .6)

**Procedura e prokurimit:** “E hapur-Mallra”

**Numri i referencës së procedurës:** REF-46816-12-26-2019

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Furnizim vendosje kamera sigurie per godinat e UKT sh.a”

**Fond limi:** 8,300,000 (tetë milionë e treqind mijë) lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*):

**Buletini i Njoftimeve Publike** Nr.52 date 30.12.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Elektrosek”sh.p.k L12122013A

Vlera 0 (zero)

2. “ I.S.S (Integrated SecuritySolutions)” sh.p.k K64112206J

Vlera 0 (zero)

3. BO“ Sireta 2 F”sh.p.k & Fredi Elektronics” sh.p.k  
K51501008J & K91803020F

Vlera 5,658,245 ( pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e dyzetë e pesë) lekë pa t.v.sh.

4. BO”Kevin Konstruksion”sh.p.k &”Eurogjici Security ”sh.p.k”

K71401004Ë & K31929010K

Vlera 6,073,175 ( gjashtë milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa t.v.sh.

5. BO“ Cara” sh.p.k & “Real Com” sh.p.k  
K07729920F & K12302006N

Vlera 7,859,000 (shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa tvsh

6.BO “Strict” sh.p.k & “Klajger Konstruksion”sh.p.k

L71717011D & K51423028P

Vlera 7,031,400 (shtatë milionë e tridhjetë e një mijë e katërqind) lekë pa tvsh.

7. “Ratech“ shpk K11521021S

Vlera 8,000,000 (tetë milionë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Elektrosek”sh.p.k

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Elektrosek” sh.p.k nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Elektrosek” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “I.S.S (Integrated SecuritySolutions)”sh.p.k

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “I.S.S (Integrated SecuritySolutions)”sh.p.k nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “I.S.S (Integrated Security Solutions)” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

3.BO”Sireta 2 F”sh.p.k &”Fred Electronics”sh.p.k

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik të paraqitur në SPE Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se për të realizuar kontratën objekt prokurimi operatorët ekonomikë BO”Sireta 2F”sh.p.k dhe “Fred Electronics”kanë paraqitur kontratën e bashkëpunimit nr.354 Rep.nr.339 kol datë 21.01.2020.

Në kontratën e bashkëpunimit konstatohet se për të realizuar kontratën objekt prokurimi “Furnizim vendosje kamera sigurie për godinat e UKT sh.a “operatori ekonomik Fredi Electronics ka marrë përsipër të realizojë 75,78 % të kontratës si dhe Sireta 2F ka marrë përsipër të realizojë 24,22 % të zërave të preventivit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomikë nga ku rezultoi si më poshtë cituar :

Së pari Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ pika 2 d)si më poshtë cituar:

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, operatori ekonomik “Sireta 2 F”sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

“Vërtetim debie” nr. 10177 prot, date 12.12.2019 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “Sireta 2 F”sh.p.k ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 12.12.2019 duke përfshirë faturën koherente të muajit Nëntor 2019.

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga pjestari i bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për

periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Dhjetor 2019.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se pjestari i bashkimit të operatorëve ekonomikë Sireta 2F sh.p.k “nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 27.12.2019 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 07.02.2019 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit Dhjetor 2019 si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.*

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 3 dhe 4 si dhe pika 7 si më poshtë cituar:

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe në listpagesat e shoqërisë për 12(dymbëdhjete) muajt e fundit, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë:

1 (nje) Inxhinier Elektrik.

Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 5 (pesë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

2(dy) punonjës Elektracist

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera

Në përmbushje të kriterëve të kërkuar në DST operatori ekonomik Fredi Elektronics ka bashkuar kapacitetet teknike për të realizuar procedurën objekt prokurimi me operatorin ekonomik Sireta 2F sh.p.k.

Duke iu referuar faktit se operatori ekonomik Sireta 2F pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë mbetet i skualifikuar për shkak se nuk ka arritur të dëshmojë shlyerjen e detyrimeve të OSHEE për muajin tashmë të maturuar muajin Dhjetor 2019 ,atëherë operatori ekonomik Fredi Elektronics mbetet i skualifikuar për shkak se si operator i vetëm nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion se përmbush disponimin e një inxhinieri elektrik drejtues teknik në liçensën e shoqërisë i pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për 12 muajt e fundit , disponimin e 5 specialistëve të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik si dhe disponimin e një mjete autovinc.

Referuar dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik për disponimin e punonjësve specialist me dëshmi kualifikimi teknik operatori ekonomik Fredi Elektronics sh.p.k ka paraqitur vetëm 1 punonjës me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik z.Th.M emërtuar si teknik elektronik.

Nga shqyrtimi i dëshmisë së kualifikimit të sigurimit teknik evidentohet se dëshmia e lëshuar për punonjësin e sipërcituar paraqitur nga operatori ekonomik Fredi Elektronics ka skaduar më datë 29.11.2018.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se edhe nëse operatori ekonomik Fredi Elektronics pretendon se i plotëson si operator i vetëm atëherë ky pretendim nuk qëndron për shkak se operatori i sipërcituar nuk përmbush kushtet e kërkuara në pikat 3,4 dhe 7 të DST.

Pra sa më sipër Shoqëria “ Fredi Electonics ” sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm si dhe mjetet teknike për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i Operatorëve Ekonomikë lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2 d) pika 3,4,7 Kapaciteti teknik është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 9 në DST shprehimisht parashikohet se....Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

4.Oferta e paraqitur nga BOE”Kevin Konstruksion”sh.p.k &”Eurogjici”sh.p.k me ofertë 6,073,175 (

gjashtë milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa t.v.sh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim Operatorësh Ekonomikë, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e përgjithshme të kualifikimit shtojca 9 si më poshtë cituar:

*Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

*a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

*b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*

*c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*

*ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

*d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.*

*Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.*

*Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.*

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

*Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:*

*a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;*

*b. Prokura e posaçme.*

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik të paraqitur në SPE Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se për të realizuar kontratën objekt prokurimi operatorët ekonomikë kanë paraqitur kontratën e bashkëpunimit nr.614 Rep.nr.193 kol datë 06.02.2020.

Në kontratën e bashkëpunimit konstatohet se për të realizuar kontratën objekt prokurimi operatori ekonomik Kevin Konstruksion sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 89,35%, ndërsa operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 10.65%.

Në marrëveshjen e bashkëpunimit ndër të tjera operatori ekonomik Kevin Konstruksion sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë zërat në kapitullin 1”Furnizim Aparature dhe pajisje si më poshtë cituar:

FV. NVR IP 32CH PoE/Netëork, HDMI 4K, FV. NVR IP 4CH PoE/Netëork, HDMI 4K, FV. Kamera bullet 4K, FV. Kamera bullet PTZ 4 MP, FV. Kamera dome 4K, FV. Kamera PTZ 3MP, FV. IP PTZ Controller, FV. Kamera bullet 5 MP, FV. Kamera dome 2 MP, FV. Sëitch aksesi 24CH 10/100/1000MB+ 2 SPF, FV. Sëitch aksesi 8CH 10/100/1000MB, FV. Hard disqe 4 TB industrial per NVR, FV. Hard disqe 2TB industrial per NVR, FV. Monitor 42" Full HD

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të ekstraktit historik të operatorit ekonomik Kevin Konstruksion sh.p.k konstaton se në objekt veprimtarie të operatorit të sipërcituar rezulton veprimtaria si më poshtë:

*Veprimtari ne fushen e ndertimit privat dhe publik,germime dheu,prodhime materiale inerte-gure;prodhim elemente betoni e beton arme te zakonshme,ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore.rikonstruksione,ndertim banesa me skela mbi 8 kate;ndertim rruge;punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge,ndertim mbi shtresa rrugore;punime hekurudhore;ndertim ura dhe vepra arti deri dhe mbi 10m;ndertim ujesjellesash kanalazime,kanale e impinate vaditje;pasrtim te siperfaqeve urbane etj. Çertifikim dhe trajnim profesional te punonjesve ne fushen e ndertimit. Grumbullim, Transportim i mbetjeve urbane. Grumbullim, transportim i mbetjeve nga ndertimet dhe prishjet.*

Referuar veprimtarisë tregtare të mësipërme të pasqyruar në QKB , KVO vëren se në asnjërin prej elementeve të mësipërme nuk rezulton të ushtrojë asnjë lloj veprimtarie për mallra import- eksport elektronike por është veprimtari e cila përfshin vetëm fushën e ndërtimit.

Nuk rezulton që operatori ekonomikë të ushtrojë veprimtari per blerje shitje mallrash elektronike kamera,,sëitch aksesi ,monitor etj.

Sqarojmë se KVO nuk është duke kërkuar që operatori ekonomik të ketë në mënyrë eksplicite kamera,sëitch apo monitor etj në objektin e veprimtarisë tregtare por duhej të kishte përfshirë në objektin e veprimtarisë edhe mallra të ngjashme me objektin e prokurimit të AK.

Vlen të theksohet se duke qënë se zërat në kapitullin 1 që kanë të bëjnë me furnizimin dhe vendosjen e mallrave kamera etj janë marrë përsipër nga operatori ekonomik Kevin Konstruksion atëherë ky operator ekonomik duhet të kishte objekt veprimtarie edhe për mallra elektronike të ngjashme.

Autoriteti kontraktor, duke qënë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se kanë në objekt veprimtarie dhe ushtrojnë aktivitetin me mallrat e ngjashme nga AK.

Pra nëpërmjet objektit të veprimtarisë operatori ekonomik garanton AK si dhe ky fundit fiton siguri dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

Bazuar në nenin 12 pika 1 e ligjit nr.9643,date 20.11.2006”Per prokurimin Publik” i ndryshuar shprehimisht citohet se ...Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit që prokuron që i jane vënë në dispozicion në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Në interpretim të dispozitave të sipërcituara duke qënë se përfituesi direkt eshte A.K UKT sh.a i

cili është i interesuari kryesor dhe që ka përgjegjësinë thelbësore në realizimin me sukses të kontratës që prokurohet të cilit ia ngarkon ligji për prokurimet publike, nuk mund të rrezikojë duke kualifikuar operatorë ekonomikë të cilët nuk e kanë objekt veprimtarie.

Autoriteti Kontraktor ka për qëllim eliminimin apo minimizimin e risqeve duke fituar garancinë dhe sigurinë që operatori ekonomik i shpallur fitues do të furnizojë AK në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Gjithashtu K.V.O thekson se, referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave me çmimin më të ulët por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që prokurohet nga operatorë ekonomikë që nuk ofrojnë garancitë e duhura për realizimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kevin Konstruksion” & “Eurogjici Security” sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e përgjithshme të kualifikimit për sa i përket objektit të veprimtarisë për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur kriteret e përgjithshme për kualifikim, çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga pjestari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k lidhur me shtojcën 9 nuk është i saktë dhe i plotë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 5 si më poshtë cituar:

Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listat e shoqërisë për periudhën Korrik 2019 - Dhjetor 2019

2 (dy) specialiste të certifikuar për sisteme monitorimi kamera. (Kontrate Pune, Libreze Pune, Diplomedhe/ose deftese)

1 Inxhinier elektronik (Kontrate Pune, Diplomedhe/ose deftese)

1 inxhinier elektrik (Kontrate Pune, Diplome dhe/ose deftese)

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik vëren se në përmbushje të kriterit të sipërcituar bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë paraqitur punonjësit e mëposhtëm:



“Kevin Konstruktion“ sh.p.k ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

- A.S për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Ing. Elektrik)
- A.S për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Manovrator)
- E. Xh për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Ing.Elektrik)
- S.M për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Hidraulik)
- B.H për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Ing.Ndërtimi)
- M.J për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Mekanik)
- N.S për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Elektriçist)
- A.P për të cilin ka paraqitur Liçencë për (Ing. Elektrik)
- N.L për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Elektriçist)
- U.GJ për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Saldator)

“Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

- A.Z për të cilin ka paraqitur Diplomë Masteri për (Ing.elektrik)
- M.H për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Spec. Monitorim Kamerash) si dhe çertifikatë për trajnim të specializuar me emërtim(operator për qendrën e kontrollit)
- A.K për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Spec. Montim Kamerash)
- G.T për të cilin ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për (Spec. Montim Kamerash)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë 2 specialist të çertifikuar përkatësisht për specialitetin “specialist monitorim kamerash”ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Certifikata e paraqitur për z.M.H lëshuar nga MSSC me titull si operator për qendrën e kontrollit nuk dëshmon specifikisht për AK se punonjësi i sipërpërmendur është i çertifikuar për sistem monitorim kamerash.

KVO-ja gjykon se nuk jemi në rastin e parashikuar nga neni 45 i ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për Prokurimin Publik”i ndryshuar që AK të kërkonte shpjegime apo verifikime mbi vërtetësinë e dokumentave të paraqitur , por jemi në kushtet e mungesës së dokumentave të kërkuar në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga BO"Kevin Konstruksion sh.p.k & Eurogjici Security "sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik për shkak se njëri nga operatorët ekonomikë" Eurogjici Security " sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket numrit të punonjësve(specialist monitorimi kamerash) për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Theksojmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Në shtojcën 12 të DST shprehimisht parashikohet se .....Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

5.Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Cara sh.p.k & Real Com sh.p.k

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik",I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim Operatorësh Ekonomikë, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e përgjithshme sipas formatit të publikuar nga APP (shtojca 8) është si më poshtë vijon:

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>1</sup>.

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezultojnë se njëri nga pjestarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë përkatësisht Real Com sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar deklaratën shtojcën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, e nënshkruar nga administratori i shoqërisë.

Nga shqyrtimi i deklaratës së dorëzuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës rezultojnë se ka deklaruar:

*“Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

1.z.P.Xh

2.z.S.K

*nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.*

Në rastin konkret, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se njëri nga pjestarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Real Com ” sh.p.k. nuk ka paraqitur deklaratën sipas shtojcës 8 të dokumentave të tenderit në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, pasi ky i fundit ka patur detyrimin e deklaramit të emrit të Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, në rastin konkret ka patur detyrimin e deklaramit të emrit të administratorit të shoqërisë përkatësisht z.M.Brraka.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se deklarata e kriterëve të përgjithshme nuk është plotësuar e plotë dhe në përputhje me formatin e publikuar nga APP.

Përsa cituam më lart operatori ekonomik pjestar i bashkimit të operatorëve ekonomikë ka qënë I detyruar ta paraqesë deklaratën të plotë si dhe konform formatit të publikuar nga APP.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 7 si më poshtë cituar:

7.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Splice machine	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

Kokore minimumi 10copë

Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë

Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë

*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, certifikate pronësie, policë sigurimi në ) rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

*Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

*Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj shoqëruar me dokumentacionin e qiradhënësit (leje qarkullimi, policë*

*sigurimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik)*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës ((Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

*Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor UKT sh.a (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi)*

Në përmbushje të kriterit të kërkuar më lart nga AK njëri nga anëtarët e bashkimit të operatorëve përkatësisht Cara sh.p.k ka deklaruar se disponon mjetet e mëposhtme:

1 Kamionçinë Benz me targa AA 936 TP, fikse zjarri , kuti ndihmëse .

Referuar listës së mjeteve të deklaruar nga operatori ekonomik si dhe dokumentacionit në sistemin elektronik të paraqitur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatorët nuk kanë paraqitur mjetet Autovinc si dhe Spliche Machine mjete këto të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit.

Në kushtet kur asnjëri nga operatorët ekonomikë nuk kanë deklaruar autovinc si dhe Spliche Machine si dhe nuk kanë paraqitur dokumentacion shoqëruar për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar atëherë kjo tregon qartazi se operatorët ekonomikë nuk disponojnë dhe nuk zotërojnë këto mjete për të realizuar kontratën objekt prokurimi nëse do të shpallehin fitues.

Mosdisponimi i mjeteve nuk garanton Autoritetin Kontraktor se operatorët do të realizonin procedurën objekt prokurimi me sukses nëse do të shpallehin fitues.

Në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime për vendosjen e kriterit të sipërcituar atëherë ka pasur momentin procedural për të ushtruar të drejtën e ankimit apo të drejtën për të kërkuar sqarime pranë Autoritetit Kontraktor sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Duke qënë se procedura e prokurimit ndodhet në fazën e vlerësimit të ofertave atëherë bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë qënë të detyruar të paraqesë dhe të përmbushë gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Cara sh.p.k&Real Com ”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme.....*

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 4 si më poshtë cituar

4. Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 5 (pesë) punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të paktën:

2 punonjës elektrikist

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik KVO konstaton se në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST bashkimi i operatorëve ekonomikë përkatësisht operatori ekonomik Cara sh.p.k ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

1.Z.U.T shoqëruar me kontratë pune,librezë pune,dëshmi e kualifikimit të sigurimit teknik

2.Z.E.H shoqëruar me kontratë punë ,librezë pune, dëshmi e kualifikimit të sigurimit teknik.

Nga verifikimi i gjithë dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik KVO vëren se operatorët ekonomikë nuk kanë paraqitur 5 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik çka bie në kundërshtim me numrin e kërkuar në DST.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Cara sh.p.k&Real Com ”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket numrit të punonjësve pasi nga 5 të kërkuar operatori ekonomik Cara sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ka paraqitur vetëm 2 punonjës me dëshmi për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se...Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Theksojmë se në një procedurë prokurimi,subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomikë ”**Strict**”sh.p.k &“**Klajger Konstruksion** “sh.p.k me adresë Tiranë,Njësia Bashkiake Nr,11 Blloku Gintash,2 kateshet e biznesit,shk 2 kati 2 Laprak & Tiranë,Kamëz Bathore (pranë kopshtit të femijëve nr .6) se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7,031,400 (shtatë milionë e tridhjetë e një mijë e katërqind) lekë pa tvsh. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 14 .02.2020**

**Ankesa: PO(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 19.02.2020**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kevin Konstruksion&Eurogjici Security ” hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr.4079 Prot. datë 18.02.2020. (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: ” Furnizim vendosje kamera sigurie per godinat e UKT sh.a”

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 28860/ 8 Prot. dt. 18.02.2020 Prot., është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 28860/9 Prot. dt. 18.02.2020 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e BOE “Kevin Konstruksion sh.p.k &Eurogjici Security”sh.p.k ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë të mësipërm dhe është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vleresimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni BO “Kevin Konstruksion&Eurogjici Security “ shpk me ane të shkresës Nr. 4079/1 datë 19.02.2020 (administruar në dosjen e prokurimit).

Gjatë ezuarimit të afateve të ankimimit bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 14 .02.2020**

**Ankesa: PO(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 19.02.2020**